



KËRKIM NË FERMË

Titulli: Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat

Punoi: L. lazaj; lida.lazaj@yahoo.com

Qëllimi: Gjatë muajit Janar 2017 vendi ynë u perfshi nga temperatura ekstremisht të ulta -8 - 12°C për një periudhë 10 ditore, gjë që shkaktoi dëme serioze në kulturën e Agrumeve. Nisur nga situata e krijuar në agrumishten e QTTB Vlorë dhe shumë parcela të tjera me Agrume në jugë të Shqipërisë ngritëm këtë kërkim në Fermë për të videntuar dëmet nga ngricat si dhe për të përcaktuar teknologjinë e duhur dhe efikase për rehabilitimin e tyre. Qëllimi është që ti këshillojmë Fermerët për masat që duhet të marrin për rehabilitimin e Agrumeve në rast përsëritje të situatës sinoptike të vitit 2017. Nisur nga rëndësia e këtij fenomeni, për të dalë në konkluzione më të sakta studimi u bë dy vjecar (2017-2018)

Vendi i ngritjes së kërkimit: Baza Eksperimentale Shamogjin dhe parcelë private prej 1.5 ha në Bamatat- Delvinë me fermer Jetmir Mehmeti.

Metodika që u perdor: E ndoqëm këtë kërkim edhe në BEP Shamogjin për vet faktin se në koleksionin e agrume janë tre specie agrume, Portokalle, Manderina dhe Limona, rreth 750 rrenjë, mbi pesë nënshartesa të ndryshme, bimë të moshës 7-vjeçare dhe sigurisht që konkluzionet e dëmtimeve nga ngricat janë më të sakta dhe më të plota .

Në tërsi koleksioni i Agrumeve pati dëmtim të masës gjethore, gjethet u vyshkën, morën ngjyrë kafe dhe u rezuan më vonë. Pjesa më e madhe çelën dhe u zhvilluan normalisht në varësi të kultivarit dhe nënshartesës përkatëse. Nuk u rigjeneruan më ata kultivarë që patën dëmtime të trungut dhe degëve kryesore.

- Duke parë shkallën e dëmtimit përcaktuam: Mënyrën e krasitjes dhe gjithë shërbimet e tjera agroteknike si më poshtë:

1-Krasitja, nuk u bën ndërhyrje të menjehershme pas ngricave por pasi u pa qartë shkalla e dëmtimit dhe reagimit të çdo kultivari. Në këtë mënyrë shmangëm prerjet e rënda, të panevojshme dhe dëmtimin e skeletit dhe kurorës së bimës.

2-U përdor plehrim i gjelbër (bathë) në një pjesë të Manderinave e cila u përmbys me anë të punimit në kohën e lulëzimit.

Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat

3-Punim me belë rreshtat e agrumeve të shoqëruara me pleh kimik DAP dhe Superfosfat – 3 herë në pranverë dhe në vjeshtë.

4- Vadijtje me pika gjatë gjithë verës në çdo 10 ditë

5- Plehrim me Ure dhe Nitrat të shoqëruara me ujitje 3 herë

Pamje nga puna e berë për rehabilitimin e agrumishtes



Gjatë vitit 2018 vazhduan shërbimet agroteknike sipas programit të përcaktuar (punime, plehrim, spërkatje, ujitje, menaxhimi i tokës) për rikthimin e koleksionit të agrumeve në parametra normal. U rishartuan nënshartesat e çelura për të zëvendësuar bimët e thara.



Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat



Si rezultat i shërbimeve të kryera u rigjeneruan katër kultivarë limoni të cilët kishin dëmtime të konsiderueshme nga ngricat (*foto më sipërkoleksion i rehabilituar*)

Në parcelën e Fermerit Jetmir Mehmeti :

Ndodhet në fshatin Bamatat–Delvinë, me sipërfaqe 1.5 ha dhe me numër bimësh 1100 rrënjë manderina Klementinë të moshës dy vjeçare nga të cilat 550 bimë mbi nënshartesën Nerenxë dhe pjesa tjetër mbi nënshartesën Trifoljat. Mbi nënshartesën Trifoljat bimët patën qëndrueshmëri të lartë ndaj ngricave ndërsa mbi nënshartesën Nerenxë, kultivari Clementinë rezultoi me qëndrueshmëri shumë të ulët, tharje në masë të bimëve. Ishte kjo arsyeja që vendosëm ta bëjmë kërkimin në fermë pikërisht në parcelën e Fermerit Jetmir Mehmeti, ku dukshëm vihej re qëndrueshmëria e të njëjtit kultivarë mbi dy nënshartesa të ndryshme.

Studimi u ngrit në tre varjante si më poshtë :

V.1. Rehabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar vetëm masa gjethore me anë të shërbimeve agroteknike

V.2. Rehabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar një pjesë e degëve skeletore dhe trungut, nëpërmjet krasitjes dhe shërbimeve të tjera agroteknike

V.3. Shkulje e bimës së dëmtuar dhe zëvendësimi me bimë të re.

Treguesit e marrë:

- Rritja e diametrit të trungut (prill –nëntor)

- Rritja mesatare e lastarëve dhe volumi ikurorës (prill-nëntor)



Në fund të vitit 2017 u bën matjet për marjen e treguesve sipas metodikës dhe patëm keto rezultate:

V1: Rehabilitimi i bimëve që u është dëmtuar vetëm masa gjethore.

Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat

Viti i pare (2017)

Bimët që ju dëmtuan vetëm gjethet të cilat morën ngjyrë kafe dhe më vonë u rëzuan u rigjeneruan totalisht, e gjithë kurora u mbush me gjelbërim të ri, patëm rritje lastarësh deri në 8 cm dhe diametër të trungut 0.7 cm (*Grafikë dhe foto më poshtë*)





Viti 2018

Vazhduan shërbimet për rehabilitimin e Manderinave mbi nënshartesën Nerenxë si: frezim i tokës, ujitje çdo 5 ditë , plehrim nëpërmjet ujitjes me pika çdo 15 ditë, si dhe trajtime kimike për mbajtjen nën kontroll të Tenjës Minuese. Dërguam mostra toke në Laboratorin e QTTB Fushë Krujë dhe nga rezultatet e analizave u hartua programi ushqimor i balancuar për periudhën në vazhdim

Në muajin Nëntor u morën treguesit e rritjes sipas metodikës dhe rezultoi si më poshtë:

Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat

Viti	Kultivari	Nënshartesa	Diametri i trungut/mm	Lartësia e bimës/cm
2017	Klementin	Nerenxë	4.3	148
2018	Klementin	Nerenxë	6.8	220



Shifrat e mësipërme kanë dalë si mesatare e matjeve të disa bimëve të mara në studim për këtë varjant. Sic shihet nga tabela dhe grafikët manderina “Klementinë” mbi nënshartesën Nerenxë, të cilave ju dëmtua vetëm masa gjithore u rigjeneruan totalisht, pati rritje mesatare vjetore të bimëve në lartësi 72 cm dhe diamëtr të trungut 1.5 cm si dhe rritje të lastarëve dhe volumit të kurorës në tërësi.

V.2. Reabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar një pjesë e degëve skeletore dhe trungut, nëpërmjet krasitjes dhe shërbimeve të tjera agroteknike

Viti i pare (2017)

Bimët që ju dëmtuan degët skeletore dhe trungu u thanë plotësisht, **nuk u rigjeneruan me**. Këto bimë u shkulën dhe u zëvendësuan me manderina “Klementinë” mbi nënshartesën Trifoljatë dhe Sw. Citrumelo


V.3. Shkulje e bimë së dëmtuar dhe zëvendësimi me bimë të re.

Një pjesë e manderinave të shartuara mbi nënshartesën Nerenxë të dëmtuara nga ngricat u shkulën dhe u zëvendësuan me bimë të reja të shartuara mbi nënshartesën Trifoljatë dhe Sw. Citrumelo. Këto bimë kishin zhvillim të mirë që vitin e parë ndërsa në fund të vitit të dytë (Nëntor 2018) janë rritur dhe janë afuar parametrave të bimëve krahasuese (manderina të cilat edhe pse mbi nënshartesën Nerenxë, nuk u dëmtuan dhe nuk u shkulën). Rezultatet e matjeve dale si mesatare e disa bimëve jepen në tabelën më poshtë:

Viti	Cultivari	Nenshartesa	Diametri i trungut/mm	Lartësia e bimës/cm
------	-----------	-------------	-----------------------	---------------------

Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat

2017	Clementinë	Trifoljatë	3.2	136
2018	Clementinë	Trifoljatë	4.1	148



Me poshtë kemi foto ku duket qartë zhvillimi i manderinave Klementinë, njëra e vitit të katërt mbi nënshartesën nerexë dhe tjetra i njëjti kultivarë mbi nënshartesën Sw.Citrumelo e vitit të dytë. Nga matjet e bëra për treguesit e rritjes së bimëve rezulton si më poshtë:

Nr.	Cultivari	Nënshartesa	Mosha/vite	Diametri/mm	Lartësia /cm
1	Clementinë	Nerexë	4	45	157
2	Clementinë	Sw.Citrumelo	2	39	145



Në të majtë është manderina Clementine/Nerexë e vitit të katërt dhe në të djathtë Manderina Clementine/ Sw. Citrumelo e vitit të dytë. Shihet qartë që i njëjti kultivar mbi dy nënshartesa të ndryshme nuk kanë të njëjtin zhvillim dhe konkretisht manderina Clementine mbi nënshartesën Sw.Citrumelo ka hecuri më mirë siç shihet edhe në foto edhe pse e vitit të dytë ka tregues rritje të përafërt (diferenca, diametri 6 mm dhe lartësia 8 cm) me manderinën Clementinë/Nerexë e vitit të katërt.

Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat

Foto pune dhe parcelë rinovuar pas ngricave



Konkluzione dhe mesazhe për fermerin:

- Në zonën e Delvinës kultivari Clementinë mbi Trifoljatë në agrumishte të re ka qëndrueshmëri të lartë ndaj ngricave, ndersa mbi nënshartesën nerenxë ka qëndrueshmëri të ulët, prandaj rekomandojmë të mbillen sa më pak fidanë mbi këtë nënshartesë pasi ka nënshartesë të tjera me qëndrueshmëri shumë të lartë siç janë Sw.Citrumelo dhe Cintrazhet në përgjithësi.

- Kur kemi të bëjmë me dëmtime të shkallës së parë nuk duhet të shqetësohemi pasi me rritjen e temperaturave dhe nëpërmjet shërbimeve agroteknike këto bimë janë tërsisht të riparueshme

- Nëse kemi dëmtime të shkallës së dytë dhe të tretë (janë dëmtuar degët skeletore dhe trungu) Këto bimë duhet të shkulen dhe të rimbillen me fidanë të ri pasi fitojme kohë në rinivimin total të Agrumishtes . Por kjo nuk do të thotë që të ndërmarim vendime të nxituara për vetë koston që ka ky proces.

- Edhe pse Limoni është specia më pak e qëndrueshme ndaj ngricave studimi tregoi se nëpërmjet shërbimeve të diferencuara disa kultivarë rigjenerohen dhe frutifikojnë vitin pasardhës.

Shpenzimet financiare të kryera per vitin 2018

Nr. i artikullit	Emërtimi i Artikullit	Plani vjetor 000/ lekë	Fakti 000/lekë
------------------	-----------------------	------------------------------	-------------------

Rehabilitimi i agrumishteve të dëmtuara nga ngricat

602	Mallra e shërbime të tjera	5	5
602.1	Materiale e shërbime speciale		
602.2	Analiza Toke	5	5
	Dieta	10	10
Totali		20	20